



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3871/2 prot.

Fushë-Arrëz, më 10.12.2025

NJOFTIM

PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË BASHKISË DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz,

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe Rregullores për funksionimin e Këshillit të Bashkisë, në bazë të mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të datës 10.12.2025, njoftoheni se mbledhja radhës e Këshillit të Bashkisë për muajin **dhjetor 2025** zhvillohet, **ditën e premte, datë 26.12.2025, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak** me rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 26.12.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.11.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Nëntor 2025.
4. Projektvendim për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2026.
5. Projektvendim për miratimin Paketës Fiskale 2026.
6. Projektvendim për miratimin e Prioriteteve në Shërbime dhe Investime për vitin 2026 e në vazhdim.
7. Projektvendim për miratimin e Planit të Aktiviteteve, Konsultimeve dhe Buxhetin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026.
8. Projektvendim për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Fushë-Arrëz.
9. Projektvendim për miratimin e bursave të nxënësve të Arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026.
10. Projektvendim për miratimin e Planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhë-Qebik në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

11. Projektvendim për dhënie në përdorim/qira Fondit pyjor për Energji të Rinovueshme në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.
12. Projektvendim për miratimin e propozimit për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë- Arrëz, Z. Kol Ded Toplana (Pas vdekjes).
13. Raporti i performancës së Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2024.
14. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
15. Të ndryshme.

MBLEDHJE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME :

- a) Mbledhja e Komisionit të Mirëqenies Sociale, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut (**Franc Doda ,Tereze Dema, Pavlin Qafa**), ditën **e marte**, datë **23.12.2025**, ora **9:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **3** të rendit të ditës.
- b) Mbledhja e Komisionit të Ekonomisë, Financave, Buxhetit, Mbikqyrjes Financiare, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, (**Franc Doda, Valentin Doçi, Valentina Lleshaj, Besjana Marku, Zef Cara**), ditën **e marte**, datë **23.12.2025**, ora **9:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **4**, pikën **5**, pikën **6** dhe pikën **7**, pikën **8** të rendit të ditës.
- c) Mbledhja e Komisionit të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve (**Besjana Marku, Tereze Dema, Franc Doda**), ditën **e marte**, datë **23.12.2025**, ora **10:30** në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **9**, pikën **12** të rendit të ditës.
- d) Mbledhja e Komisionit të Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit (**Mustaf Pashkaj, Nikolin Sadikaj, Pavlin Qafa**) ditën **e marte**, datë **23.12.2024**, ora **11:30**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit për pikën **10**, pikën **11** të rendit të ditës.

Duke kërkuar korrektësinë tuaj për pjesëmarrjen në mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjen plenare të Këshillit të Bashkisë!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

